VENDIM
Nr.1, datë 19.1.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar	i	“	“
Fehmi Abdiu	Anëtar	i	“	“
Kujtim Puto	Anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Petrit Plloçi	Anëtar	i	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare	e	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datën 7.10.2008, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.17 Akti, që i përket:

KËRKUES: ARBEN BAJRAKTARI, përfaqësuar nga Av. Vangjel Kosta, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE, përfaqësuar nga Av. Neshat Fana, me prokurë.

ZYRA E PËRMBARIMIT TIRANË, përfaqësuar nga z. Arben Matani, me autorizim.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

BAZA LIGJORE: Neni 42/1, 131/f, 132/1, 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27 e 28 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Vitore Tusha; përfaqësuesin e kërkuesit që u shpreh për pranimin e kërkesës; përfaqësuesit e subjekteve të interesuara që kërkuan rrëzimin e kërkesës dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Kërkuesi ka punuar në administratën doganore duke filluar nga data 24.3.1999. Ai është emëruar kryetar i degës doganore Durrës më datë 16.9.2005, me aktin nr.6954 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, detyrë në të cilën ka punuar deri më datë 10.11.2005. Kërkuesi është liruar nga kjo detyrë me aktin nr.9045, datë 10.11.2005 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave. Marrëdhëniet financiare janë ndërprerë në datën e lirimit nga detyra me aktin nr.459/1 datë 30.11.2005. Më datë 14.12.2005 kërkuesi është njoftuar se vihet në dispozicion të Ministrisë së Financave për t’u emëruar në një pozicion pranë kësaj Ministrie. Me aktin nr.3150/34, datë 12.4.2006, kërkuesit i është komunikuar përsëri ndërprerja e marrëdhënieve të punës.

Kërkuesi ka kundërshtuar në Komisionin e Shërbimit Civil (KSHC) aktin nr.9045, datë 10.11.2005 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, me të cilin është urdhëruar lirimi nga detyra e kryetarit të degës Doganore Durrës.

KSHC-ja, me vendimin nr.266, datë 23.12.2005, ka vendosur të shfuqizojë aktin nr.9045, datë 10.11.2005 si akt i pabazuar në ligj, duke urdhëruar kthimin e kërkuesit në vendin e mëparshëm të punës dhe pagimin e pagës për të gjithë kohën e qëndrimit padrejtësisht pa punë, nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare. Subjekti i interesuar, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD) humbi afatin ligjor për kundërshtimin e vendimit të KSHC-së dhe paraqiti kërkesë për rivendosjen në afat të padisë.

Gjykata e Apelit, me vendimin nr.18, datë 21.3.2006, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për rivendosjen në afat të kërkesëpadisë së ngritur nga DPD-ja. Ndërsa, me vendimin nr.31, datë 6.4.2006, po kjo gjykatë ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit të formës së prerë nr.18, datë 21.3.2006.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.43, datë 23.3.2007, ka rrëzuar kërkesën e DPD-së me objekt pezullimin e vendimit nr.266, datë 23.12.2005 të KSHC-së dhe me vendimin nr.688, datë 22.5.2007 ka lënë në fuqi vendimin nr.18, datë 21.3.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Pas lëshimit të urdhrit të ekzekutimit nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.31, datë 6.4.2006, subjekti i interesuar DPD ka urdhëruar përsëri ndërprerjen e marrëdhënieve të punës të kërkuesit me aktin nr.3150/34, datë 12.4.2006.

KSHC-ja me vendimin nr.361, datë 13.5.2006, ka vendosur shfuqizimin e aktit nr.3150/34, datë 12.4.2006 "Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës" si të pabazuar në ligj.

Gjykata e Apelit me vendimin nr.200, datë 14.11.2006 ka vendosur rrëzimin e padisë së DPD-së dhe me vendimin nr.60, datë 1.2.2007 ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Apelit nr.200, datë 14.11.2006.

Kërkuesi i është drejtuar Zyrës së Përmbarimit për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë nga DPD-së. Zyra e Përmbarimit Tiranë ka urdhëruar DPD-në për ekzekutimin e vendimit me shkresat nr.3490 Prot. datë 14.4.2006, nr.6762 Prot, datë 26.6.2007, nr.174 Prot, datë 10.1.2008, nr.4564 Prot., datë 14.5.2008. Urdhërimet për ekzekutimin e vendimit, kanë rezultuar të pasuksesshme.

II

Kërkuesi pretendoi:

- cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e ngarkuara nga ligji, brenda afatit të arsyeshëm, në kuptimin e nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së;
- ka hasur në refuzimin dhe pasivitetin e organeve kompetente për të ekzekutuar vendimin e formës së prerë;
- ka shteruar të gjitha mjetet ligjore në dispozicion për përmbushjen e këtij qëllimi brenda afatit të arsyeshëm.

Përfaqësuesi i DPD-së pretendoi:

- Kërkuesi nuk legjitimohet për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, pasi nuk ka shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të pretenduara, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Pranë Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë gjenden ende të pashqyrtuara disa rekurse të paraqitura si nga kërkuesi, ashtu dhe DPD-ja kundër vendimeve gjyqësore që kanë lidhje me çështjen objekt gjykimi në Gjykatën Kushtetuese.
- Vendimi i KSHC-së është akt absolutisht i pavlefshëm, pasi është nxjerrë jashtë kompetencave të parashikuara nga ligji, në referim të vendimeve unifikuese nr.8 dhe nr.10, datë 12.9.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi i Gjykatës nuk përmban urdhërime, pasi nuk e ka shqyrtuar çështjen në themel, prandaj nuk përbën titull ekzekutiv.
- Vendimi nr.266, datë 23.12.2005 i KSHC-së është ekzekutuar, pasi kërkuesi, me

shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr.1097/1, datë 22.11.2007, është emëruar përgjegjës zyre në sektorin e Task-Forcës në Drejtorinë e Policisë Tatimore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Përfaqësuesi i zyrës së përmbarimit pretendoi se ka vepruar në përputhje me procedurat e parashikuara nga ligji.

III

1. Lidhur me pretendimin e subjektit të interesuar mbi legjitimitetin e kërkuesit

Çështja e legjitimitetit të kërkuesit lidhet drejtpërdrejt me inicimin e një procesi kushtetues. Individi, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese kur pretendon se i janë cenuar të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka vlerësuar se shterimi i mjeteve juridike nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (vendimin nr.6, datë 31.3.2006; vendimi nr.27, datë 20.6.2007). Shterimi i mjeteve të ankimit është trajtuar edhe nga jurisprudenca e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, e cila në çështjen "Qufaj kundër Shqipërisë" është shprehur se ankuesit duhet të përdorin mjetet ligjore që sipas sistemit juridik të brendshëm janë zakonisht në dispozicion të palëve dhe të mjaftueshme për të vënë në vend të drejtat e shkelura.

Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga ankuesi, i cili para se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura.

Gjatë hetimit të çështjes rezultoi se asnjë instancë gjyqësore nuk ka shfuqizuar apo ndryshuar vendimin nr.266, datë 23.12.2005 të KSHC-së, në të cilin urdhërohet subjekti i interesuar, DPD-së të kthejë kërkuesin në vendin e mëparshëm të punës dhe t'i paguajë pagën për të gjithë kohën e qëndrimit padrejtësisht pa punë nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare. Gjithashtu, asnjë instancë gjyqësore nuk ka shfuqizuar apo ndryshuar vendimin nr.31, datë 6.4.2006 të Gjykatës së Apelit, i cili ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin e formës së prerë nr.18, datë 21.03.2006.

Subjekti i interesuar, DPD, e motivon pretendimin për mosshterimin e mjeteve juridike me argumentin se pranë Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë gjenden ende të pashqyrtuara disa rekurse të paraqitura si nga kërkuesi, ashtu dhe DPD kundër vendimeve gjyqësore që kanë lidhje me çështjen objekt gjykimi.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se disa shkresa të Drejtorit të DPD-së, me urdhërime të ndryshme për kërkuesin, janë bërë objekt gjykimi i disa proceseve administrative dhe gjyqësore. Fakti, që aktet e kundërshtuara janë nxjerrë në kohë dhe me objekt të ndryshëm, ka përjashtuar mundësinë e bashkimeve midis tyre. Çështjet gjyqësore, të cilat janë ende në proces në Gjykatën e Lartë, nuk kanë lidhje me çështjen objekt gjykimi në Gjykatën Kushtetuese, për shkak të objektit të ndryshëm të gjykimit.

Sa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se kërkuesi ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohur nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtën e shkelur.

2. Lidhur me pretendimin e kërkuesit për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda afatit të arsyeshëm.

Ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi të formës së prerë të gjykatës duhet konsideruar si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (vendimi nr.27, datë 20.6.2007 i Gjykatës Kushtetuese). Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (vendimi nr.6, datë 31.3.2006 i Gjykatës Kushtetuese).

Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës

konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend i një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Gjykata Kushtetuese konsideron se autoritetet shtetërore nuk mund të përmendin mungesën e fondeve si justifikim për të mos respektuar një detyrim financiar që vjen nga një vendim gjyqësor. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (vendimi nr.43, datë 19.12.2007).

Gjykata Kushtetuese rikonfirmon qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces.

Ekzekutimi i vendimeve brenda afatit të arsyeshëm ka qenë në fokusin e vazhdueshëm edhe të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, e cila në jurisprudencën e saj, në mënyrë të vazhdueshme, ka rikonfirmuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes, dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen e aplikantit dhe autoriteteve përkatëse, si dhe interesin e aplikantit. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara, volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme. Përsa i përket sjelljes së aplikantit/kërkuesit, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se përdorimi nga ana e aplikantit i të gjitha procedurave të parashikuara nga e drejta e brendshme, me qëllim sigurimin e mbrojtjes, nuk mund të përdoret si argument kundër tij. Përsa i përket sjelljes së autoriteteve, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se edhe në ato sisteme ligjore, të cilat zbatojnë parimin se iniciativat procedurale u takojnë palëve, përsëri gjykatat kanë detyrimin për të siguruar progresin e gjykimeve me shpejtësi të mjaftueshme (vendimi "Cravcenko kundër Moldavisë", GJEDNJ, datë 15.4.2008).

Çështja objekt gjykimi nuk paraqet kompleksitet nga pikëpamja faktike apo ligjore, çka mund të justifikonte vonesat apo sjelljen mosvepruese të organeve të ngarkuara nga ligji, DPD-ja dhe zyra e përmbarimit. Përsa i përket sjelljes (veprimeve) së/të kërkuesit, Gjykata konstaton se kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion të tij për rivendosjen e së drejtës së cenuar.

Përmbaruesi gjyqësor, si subjekt procedural në fushën e ekzekutimit, është i pajisur me të gjitha mjetet procedurale që mundësojnë ekzekutimin e titullit ekzekutiv. Përfaqësuesi i zyrës së përmbarimit pretendoi se përmbaruesit gjyqësor kishin zbatuar dispozitat procedurale mbi ekzekutimin vullnetar, deri në gjobitjen e personit të ngarkuar nga ligji për mosekzekutim vullnetar të detyrimit. Gjykata vlerëson se veprimet e kryera nga përmbaruesi gjyqësor kanë qenë të pasuksesshme për shkak të mosushtrimit të të gjitha kompetencave nga ana e tij. Gjykata Kushtetuese vlerëson se përballë detyrimit për zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të gjitha subjektet, qofshin këto private apo publike, duhet të përgjigjen njëlloj.

DPD-ja ka kundërshtuar ekzekutimin e vendimit me argumente që kanë të bëjnë me paligjshmërinë e vendimit të KSHC-së, vënien në dyshim të vlerës së tij si titull ekzekutiv dhe pamundësisë financiare për përmbushjen e detyrimit. Gjykata Kushtetuese konstaton se DPD-ja ka refuzuar në mënyrë të vazhdueshme e të pajustifikuar ekzekutimin e titullit ekzekutiv.

Në lidhje me pretendimin e DPD-së mbi pavlefshmërinë e vendimit të KSHC-së si vendim i nxjerrë nga një organ jashtë kompetencave të parashikuara nga ligji, Gjykata Kushtetuese çmon se vlerësimi i këtij pretendimi i përket juridiksionit të gjykatës së zakonshme, dhe jo juridiksionit kushtetues.

Gjykata Kushtetuese vlerëson të pabazuar edhe pretendimin se vendimi i gjykatës nuk është titull ekzekutiv. Vënia në dyshim e fuqisë ekzekutive të vendimit të gjykatës, nisur nga fakti

se çështja nuk është zgjidhur në themel dhe dispozitivi i vendimit nuk përmban detyrime në të, është e pabazuar. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues nr.3, datë 24.1.2007 kanë arritur në konkluzionin se Komisioni i Shërbimit Civil ka tiparet e një arbitri administrativ apo të një trupe (organi) me funksion dhe kompetenca *quasi* gjyqësore. Vendimi i KSHC-së ngjason me vendimin e dhënë nga gjykata e shkallës së parë, nisur nga tiparet e tij dhe nga fuqia detyruese që ligjvënësi i ka dhënë në rastet kur ai nuk ankimohet brenda afatit ligjor.

Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut vëren se, pavarësisht nëse vendimi përfundimtar për t'u ekzekutuar merr formën e një vendimi gjykate ose një vendimi të një autoriteti administrativ, legjislacioni i brendshëm dhe Konventa parashikon që ai duhet të ekzekutohet (Çështja "Ramadhi kundër Shqipërisë" datë 13 nëntor 2007).

Përsa i përket pretendimit se vendimi nr.266, datë 23.12.2005 i KSHC-së është ekzekutuar, pasi kërkuesi është emëruar përgjegjës zyre në Sektorin e Task-Forcës në Drejtorinë e Policisë Tatimore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Gjykata Kushtetuese vlerëson se punësimi i kërkuesit me vendimin nr.1097/1, datë 22.11.2007 nuk përmbush urdhërimet e vendimit të KSHC-së.

Sa më sipër, Gjykata Kushtetuese nuk gjen arsye të bazuara që kanë çuar në mosrealizimin e të drejtës së kërkuesit për një proces të rregullt ligjor nëpërmjet refuzimit për moszbatim të vendimit të formës së prerë nga organet kompetente. Gjykata vlerëson se në çështjen në shqyrtim, Zyra e përmbarimit dhe DPD-ja i kishin të gjitha mundësitë që gjatë gjithë periudhës, nga dita e marrjes formë të prerë të vendimit e në vazhdim, të ekzekutonin vendimin e formës së prerë.

Si përfundim, në vijim të arsyetimit të mësipërm, në çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata Kushtetuese konstaton se mosekzekutimi i vendimit të formës së prerë ka sjellë cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor të kërkuesit të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 49/2 e 51 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e moszbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.18, datë 21.3.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar), Fehmi Abdiu, Gjergj Sauli, Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Kujtim Puto, Vitore Tusha, Sokol Sadushi, Sokol Berberi